ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I GRAÇANICËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **GRA618-24-10315-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ Grupi i OE "VIA EGNATIA SH.P.K. & Enggroup SH.P.K." ____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____Rr. "Mustafë Veselaj"_____
(Adresa)

_____Prishtinë_____ **_____10000_____**
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____ +383 44219080 _____ **_____**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____ Genc Muçolli _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ viaegnatiashpk@gmail.com _____
(Adresa elektronike)

_____15.05.2025_____ **_____**
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **"Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës"**.

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 02.10.2024 ndërsa hapja e tenderëve është bërë me datën 17.10.2024.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 30.10.2024

Të pakënaqur me këtë vendim me datë 04.11.2024 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 07.11.2024 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim me datë 18.11.2024 iu kemi drejtuar OSHP-së me këtë ankesë.

OSHP me datë 29.01.2025 përmes Vendimit 2024/1121 e ka kthye rastin në rivlerësim.

AK pas rivlerësimit, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke e anuluar prap tenderin ndërsa neve na ka eliminuar si të papërgjegjshëm.

Të pakënaqur me këtë vendim me datë 03.02.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 04.02.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim me 05.02.2025 iu kemi drejtuar OSHP-së me Ankesë.

OSHP me datë 11.04.2025 përmes Vendimit të tyre e ka kthyer prapë rastin në rivlerësim. AK pas rivlerësimit, me datë 07.05.2025 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke e anulua tenderin ndërsa neve na ka eliminuar edhe për herën e tretë si të papërgjegjshëm.

Të pakënaqur me këtë vendim, me datë 11.05.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 14.05.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja e tenderëve është bërë më datën 17.10.2024. Gjate hapjes së tenderëve nuk është evidentua ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 02.10.2024 ndërsa hapja e tenderëve është bërë me datën 17.10.2024.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 30.10.2024

Të pakënaqur me këtë vendim me datë 04.11.2024 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 07.11.2024 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim me datë 18.11.2024 iu kemi drejtuar OSHP-së me këtë ankesë.

OSHP me datë 29.01.2025 përmes Vendimit 2024/1121 e ka kthye rastin në rivlerësim.
AK pas rivlerësimit, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke e anuluar prap tenderin ndërsa neve na ka eliminuar si të papërgjegjshëm.

Të pakënaqur me këtë vendim me datë 03.02.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 04.02.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim me 05.02.2025 iu kemi drejtuar OSHP-së me Ankesë.

OSHP me datë 11.04.2025 përmes Vendimit të tyre e ka kthyer prapë rastin në rivlerësim.

AK pas rivlerësimit, me datë 07.05.2025 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së duke e anulua tenderin ndërsa neve na ka eliminuar edhe për herën e tretë si të papërgjegjshëm.

Të pakënaqur me këtë vendim, me datë 11.05.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 14.05.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk kanë luajtur rol aktiv për t'u siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë **efikase, efektive, ekonomike** dhe vetëm për qëllimin e lëndës. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit për këtë procedurë. Më saktësisht AK pa asnjë të drejtë ligjore po mundohet ta anuloj tenderin vetëm sa për të mos na shpërblyer neve me kontratë si GOE i vetëm i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Arsyetimi i AK-së tek anulimi i tenderit nuk është real dhe as i bazuar për çka i njëjti bie ndesh me nenin 62 i LPP-së dhe me neni 43 i RRPP-001/2022. Mos aplikimi si duhet i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit e shtynë AK-në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 1 dhe 6 të LPP-së por edhe drejt shkeljeve tjera sepse me këtë veprim po tenton që në kundërshtim me realitetin dhe në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së të anuloj tenderin.
Me që në këtë tender jemi vetëm ne si tenderues i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë tenderuesit tjerë, atëherë shpërblimi jonë me kontratë është detyrim ligjor ku veprimi ndryshe konsiderohet shkelje e plotë dhe mos shfrytëzim i mjeteve në formën më efikase, efektive, ekonomike dhe vetëm për qëllimin e lëndës ashtu siç e kërkon neni 1 dhe 6 i LPP-së. AK nuk ka marrë për bazë fare sqarimet e ofruara nga ne pas kërkesës së tyre dhe tani e ka zgjeruar arsyetimin e eliminimit me gjëra të kota kinse vonesa në sqarim të çmimeve ku për qëllim të vetëm ka anulimin e tenderit dhe vetëm sa për të mos na shpërblyer neve me kontratë.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke mos respektuar kërkesat e neneve tjera të cekura në vazhdim në pretendimet tona.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër asaj që ne jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm dhe posedojmë çmimin më të ulët në krahasim me të gjithë aplikuesit tjerë, AK nuk na ka shpall fitues por në mënyrë të kundërligjshme për tenton ta anuloj tenderin në fjalë. Ky anulim dyshohet se po bëhet për të i favorizuar dhe për të ju dhënë edhe një mundësi GOE-ve që tani në këtë tender nuk kanë arritur të jenë të përgjegjshëm dhe nuk kanë arritur të ofrojnë as çmimin më të ulët.
Vlen të theksohet se GOE që posedojnë çmime më të larta se ne, janë të papërgjegjshëm si për nga aspekti i plotësueshmërisë së kërkesave për pajisjet e po ashtu edhe për nga mënyra e ofrimit të çmimeve tek paramasa. Nga dokumentet e tyre shihen qartë se tenderët e tyre janë jo të rregullt prandaj mos trajtimi i tyre dhe tentimi për anulim të tërë procesit nga ana e AK-së, konsiderohet **favorizim** i plotë ndaj tyre dhe tentim për një mundësi të dytë në rishpallje ose kontraktim me negocim. Kjo nuk është vetëm favorizim por në një formë është edhe bashkëpunim në manipulim me GOE-et në fjalë që nuk janë fare të përgjegjshëm. Kjo nuk lejohet me asnjë nga dispozitat ligjore që flasin për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit andaj shihet hapur se AK i ka favorizuar të njëjtit. Përpos kësaj tentimi i AK-së që të na eliminoj me një arsyetim të manipuluar kinse jemi vonuar në kthim të përgjigjes sqaruese tek AK, si veprim konsiderohet mashtrim dhe me të drejt e themi se konsiderohet edhe vepër penale. Mashtrimi i AK-së duke tentuar ta fsheh datën e parashtrimit të kërkesës për sqarim ku e ka ringarkuar kërkesën e njëjtë sa për të mos u ditur se kur ishte ngarkuar kërkesa e parë, është shkelje e plotë e nenit 1 të LPP-së nga ana e AK-së, andaj për këtë mashtrim kërkojmë nga OSHP që të merren edhe masa ndaj tyre. Se si ka tentuar AK të mashtroj me datën e ngarkimit të kërkesës për sqarim, do të ju njohim në pretendimet që do të i sqarojmë në vazhdim. Kjo vonese më së shumti po i konvenon GOE që ishte konkurrent i papërgjegjshëm i cili e kishte kontratën e mëhershme, sepse për deri sa po vonohet procesi i përzgjedhjes së fituesit të ri, dyshohet se GOE në fjalë po realizon shërbime me kontrata të negociuara dhe atë me çmime shumë të larta. Përpos kësaj AK qëllimisht nuk na e ka konstatua si mangësi çështjen e çmimeve jo normalisht të ulëta me të vetmen arsye që të mundet ta përdor atë në rivlerësimin e radhës si arsye tjetër për eliminim, dhe nga krejt kjo po shihet se krejt qëllimi është zgjatja sa më shumë e periudhës kohore deri në përfundim të procesit dhe krijimi i vonesave të cilat i konvenojnë shumë GOE që po kryen shërbimet e tilla me kontraktime direkte.
AK ka shkelur nenit 7 të LPP-së edhe duke na diskriminuar neve pa asnjë të drejtë ligjore pasi që edhe pse jemi të vetmit si të përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim me konkurrencën, nuk shpallemi fitues.
Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë, favorizimin dhe në të njëjtën kohë diskriminimin e tenderuesve.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar fare kërkesat e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të publikuar për këtë qëllim. **AK ka bërë shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së me rastin anulim të tenderit pasi që nuk i ka marrë fare për bazë**

sqarimet tona që na i ka kërkuar. AK pas rivlerësimit i ka cilësuar si të papërgjegjshëm të dy GOE që posedojnë çmimin më të lartë se ne, dhe është munduar që edhe neve të na eliminoj si të papërgjegjshëm edhe përkundër që i kemi ofruar sqarime shumë bindëse dhe të detajuara në kërkesën e tyre. Anulimi i tenderit është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së që reflekton edhe në shkelje të nenit 61 dhe 62 të LPP-së dhe nenit 41 dhe 43 të RRPP-001/2022. Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë në rastin e tretë të vlerësimit duket kështu:

> *Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm:
> ARSYETIM
> *Tenderi juaj është refuzuar* për këto arsye:
> Duke ju referuar Formularit B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet, te derguar nga ne si Autoritet Kontraktues ne drejtim te Grupit të Operatorit Ekonomik me daten 18.04.2025, ku pas marrjes se "sqarimit" nga GOE me daten 23.04.2025. ne si Autoritet Kontraktues nuk kemi marr pergjigjje ne pyetjet e drejtuara GOE.
>
> Pra ne si Autoritet Kontraktues ne menyre qe te vazhdojme me procedura te rregullta te prokurimit kemi derguar Formularin B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet ne drejt te GOE "VIA EGNATIA" SH.P.K. & "ENGGROUP" SH.P.K. me daten 18.04.2025 ne lidhje me disa pozicione ne paramasen dhe parallogarine ne te cilat GOE ka oferuar çmim jo-normalisht te ulet pra ne vlere prej 0.10 euro per ore.
>
> 3.01. Angazhimi i një eskavatori të rëndë, vlera e oferuar per ore: 0.10 euro
> 3.02. Angazhimi i një grejderi mbi 12t, vlera e ofëruar për orë: 0.10 euro
> 3.03. Angazhimi i një ngarkuesi mbi 18t, vlera e ofëruar për orë: 0.10 euro
> 3.05. Angazhimi i nje eskavatori deri ne 7t së bashku me kamion për transportin e materialit, vlera e ofëruar për orë: 0.10 euro
> 3.06. Angazhimi i nje eskavatori deri ne 16t së bashku me kamion për transportin e materialit, vlera e ofëruar për orë: 0.10 euro.
> 3.07. Angazhimi i nje eskavatori deri ne 22t së bashku me kamion për transportin e materialit, vlera e ofëruar për orë: 0.10 euro.
> 2.08. Furnizim me kryp, vlera e oferuar per ton: 40.00 euro.

> GOE në letrën e përcjellur ne drejtim të AK me datën 23.04.2025 nuk keni oferuar përgjigjje në pytjet e cekura ne formularin B41 të datës 18.04.2025, ne baze te *Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)* Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët pika *4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jonormalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.*
>
> Në këtë rast GOE në Sqarimin e derguar nuk ka oferuar pergjigjje ne lidhje me pyetjet e AK brenda afatit ligjore prej 5 diteve nga data e dërgimit të Kërkesës së AK për sqarime më të hollësishme dhe më të detajuara në lidhje me pyetjet e derguara, në të vetmen pyetje të përgjigjur parcialisht dhe jo bindshem është në lidhje me pozicionin 2.08. Furnizim me kryp për të cilën GOE, ku është letrën sqaruese është prezantuar një PRO-FATURE e cilat nuk përbën obligim ligjore kundrejt asnjëres palë, i cili sqarim është i mangët dhe jo bindës.
>
> Pra duke ju referuar letres për sqarim të GOE është e pamundur të vazhdojmë tutje pasi që GOE nuk ka oferuar sqarime brenda afatit ligjor prej 5 ditëve në pyetjet e dërguara nga AK andaj ne si AK duke ju referuar *Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)* Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët pika *4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jonormalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të:*
> ***Refuzojmë Tenderin Abnormalisht te Ulët.***

Arsyetimi i tillë për eliminim shihet se është i manipuluar ku vërehet qartë se në të nuk korrespondojnë të dhënat e ofruara nga AK në mes veti. Fillimisht po e sqarojmë konstatimin e pabazuar të AK-së për gjoja vonesën tonë në ofrimin e sqarimeve në kërkesën e kërkuar nga AK.
Këtu po shihet se në mënyrë shumë perfide AK ka provuar të fshehë realitetin mbi datën e dërgimit të kërkesës për sqarim e cila na ishte dërguar me datën 18.04.2025 duke ngarkuar kërkesën e njëjtë edhe një here me datën 07.05.2025, dhe atë saktë në datën kur e ka dërguar edhe njoftimin mbi vendimin e AK-së me të vetmin qëllim për të fshehur datën reale të dërgimit të kërkesës për sqarim. Këtë e ka bërë qëllimisht duke menduar se mundet të na e hedh kollaj edhe pse brenda në kërkesën e dërguar me datë 18.04.2025 kishte lënë datën e përgatitjes së kërkesës 16.04.2025 të cilës tani po i referohet. Përpos kësaj vet AK tek arsyetimi për anulim po shihet se disa here ka theksuar datën 18.04 2025 si datë të dërgimit të kërkesës për sqarim, që tregon se arsyetimi i tillë është i pabazuar.

Ja disa nga faktet:



Ja si e përshkruan vet AK në arsyetimin për eliminim datën e dërgimit të kërkesës për sqarim:


Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Duke ju referuar Formularit B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet, te derguar nga ne si Autoritet Kontraktues ne drejtim te Grupit të Operatorit Ekonomik me daten 18.04.2025, ku pas marrjes se "sqarimit" nga GOE me daten 23.04.2025. ne si Autoritet Kontraktues nuk kemi marr pergjigjje ne pyetjet e drejtuara GOE.

Ndërsa për të ju bindur dhe faktuar për datën e dërgimit të kësaj kërkese për sqarim nga ana e AK-së, po ju paraqesim edhe këtë foto ku shihet data e saktë e dërgimit dhe kërkesës së tillë:





Pra po shihet se konstatimi i AK-së për gjoja që ne jemi vonuar me sqarimin e dërguar me datën **23.04.2025** nuk qëndron fare dhe se krejt kjo është vetëm një tentim për të manipuluar me procesin e vlerësimit dhe për ta anuluar tenderin me çdo kusht.

Këtu po shihet qartë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1.2, 1.3 dhe 59 të LPP-së duke mos respektuar afatin që vet e ka dhënë në kërkesën e dërguar për sqarim me datë 18.04.2025.

Po ta kishte marrë për bazë dhe ta kishte trajtuar sqarimin tonë, AK do të i gjente aty të gjitha të dhënat detale që arsyetojnë plotësisht çmimet e tenderit tonë andaj nuk kemi se si mos të mendojmë ndryshe përveç se AK ka manipuluar në rastin konkret duke shkelur parimet bazë të prokurimit e mandej edhe nenet e ligjit të cekura më lartë.

Edhe konstatimi tjetër i AK-së për gjoja ne nuk kemi ofruar sqarime në kërkesën e AK-së nuk qëndron dhe këtu AK bie ndesh me vet veten ku herë i referohet sqarimit të dërguar nga ne me datë 23.04.2025 e më pas e thotë që s'keni ofruar sqarime duke e ngatërruar atë me gjoja vonesën e dërgimit të sqarimeve gjë të cilën e sqaruam më sipër. Për të ju bindur se ne kemi dërguar sqarimet e kërkuara sipas rregullave, mjafton ta lexoni me kujdesë shkresën tonë që ia kemi dërguar AK-së me datën 23.04.205 për çka besojmë se do të bindeni edhe ju se çmimet tona janë çmime të tregut me të cilat AK operon prej më shumë se 5 viteve. Këtu po ua paraqesim vetëm një pjesë të shkresës tonë që tregon datën e dërgimit tek AK, e për detaje tjera ju lusim që ta lexoni komplet shkresën që ndodhet e bashkangjitur si dhe atë që është thënë në sqarimin e ofruar tek **pretendimi 5**, ku faktohet veprimi i kundërligjshëm i AK-së në mos pranimin e sajë.



Për: **KOMUNA E GRAÇANICËS** – Departamenti i Prokurimit

Nga: Grupi i OE "**VIA EGNATIA SH.P.K. & Enggroup SH.P.K.**" - Prishtinë

Lënda: Sqarim lidhur me kërkesën e AK-së të datës 18.04.2025 për të ofruar informata rreth disa çmimeve në tenderin: "**Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës**" me Nr. të Prokurimit: **GRA618-24-10315-2-1-1**

Datë: **23.04.2025**

Të nderuar/a,

Me që AK nuk e ka trajtuar fare vërtetësinë e sqarimeve tona për çmimet jo normalisht të ulëta atëherë ne nuk po e elaborojmë edhe një here këtu, ndërsa si të bashkëngjitur e gjeni sqarimin e datës 23.04.2025 me detaje dhe nëse e njëjta do vlerësohej drejt nga AK, realisht do duhej që vet ata ta kthenin lëndën në rivlerësim dhe të na shpallnin si fitues të tenderit.

Pra nga kjo po shihet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderit tonë dhe përpos kësaj ka shkelur edhe dispozita tjera të po këtij ligji të cilat flasin decidivisht për afatet kohore të përgjigjeve. Për më keq, AK ka shkelur nenin 1.2 dhe 1.3 të LPP-së pasi që pa kurrfarë etike dhe pa kurrfarë integriteti është mundur ta fsheh datën e dërgimit të kërkesës për sqarim dhe më pas e ka përdorur si shkas tek arsyetimi për eliminim për gjoja vonesë në dërgim të sqarimeve nga ana jonë. Nëse ka nevojë për sqarime më të detajuara lidhur me datat e tilla, eksperti shqyrtues mundet lirisht të i drejtohet KRPP-së (Departamentit të Teknologjisë Informative) që të shohë më detalisht se kur AK e ka dërguar kërkesën për sqarim dhe se a e kemi kthyer ne përgjigjen me kohë.

Përpos shkeljeve të bëra gjatë vlerësimit të tenderit tonë, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe me rastin e cilësimit të GOE-ve tjerë si të papërgjegjshëm me të vetmen arsye për çmime tre shifrore edhe pse të dy konkurrentët kanë mangësi tjera të theksuara në tenderët e tyre. Në vazhdim po i rendisim edhe mangësitë tjera të e GOE-ve konkurrent që AK nuk i ka vlersuar fare por që ua ka atribuar vetëm shkeljen për gabimet në ofertim me çmime tre shifrore.

Mangësitë në tenderin e GOE "NNT ABC SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.":
Ky Grup i OE fillimisht ka mangësi tek paramasa pasi që disa nga çmimet i ka ofruar me më shumë presje dhjetore se sa që lejohen me ligj dhe dosje së tenderit. Në rastin konkret tek pozicioni 2.10, 2.11 dhe 3.04 ka ofruar çmimin 0.004€, 0.004€ përkatësisht 0.001€. Kur të merret për bazë ajo që e kërkon neni 17.11 i RRPP-001/2022, del që tenderuesi i tillë është i papërgjegjshëm. Mangësia e këtij GOE është mos dorëzimi i organogramit sipas ligjit dhe rregullores mbi organizmin e kompanive pasi që ky organogram i posedon vetëm katër pozitat udhëheqëse dhe nuk dihet fare se sa është numri i punëtorëve e as shpërndarja e tyre në sektorë.

Mangësi tjetër e rëndësishme është ajo e mos posedimit të pajisjeve sipas kërkesave të AK-së. E themi këtë sepse ky GOE nuk ka ofruar dëshmi të vlefshme si në vazhdim:

- Tek pika 7. e listës së pajisjeve nuk ka dhënë informata mbi fuqinë e makinës ashtu siç e ka kërkuar nga AK. Kur të qasemi në internet, tipi i makinës së tillë nuk posedon fuqinë e kërkuar nga AK andaj edhe nuk mundet të pranohet. Ky GOE ka tek fajlli 14, faqe 48-49 ka paraqitur një faturë të plotësuar me dorë të lirë dhe ka dhënë fuqinë 138KW por që dyshohet se nuk është vërtetë pasi që makineria e njëjtë në internet nuk posedon fuqinë e tillë. Shihe linkun për pajisjen e tillë:https://www.troostwijkauctions.com/en/l/o-k-l25-5-shovel-2002-A1-22288-13
- Tek pika 8 e listës është paraqitur kompresori si gjysmërimorkio speciale-kompresor qe tërhiqet ku sipas ligjit për regjistrim te automjeteve ne RKS, ky mjet duhet te regjistrohet sepse kalon peshën mbi 750kg. Tek fatura e paraqitur në PDF si dhe tek DUD-i i doganës shihet se pajisja e tillë peshon 1990kg andaj paraqitja e sajë pa regjistrim nuk mundet të pranohet.
- OE ka ofruar kokë tërheqëse me targa 01-967-QQ dhe gjysmërimorkio për bartjen e automjeteve me targa: 01-659-XB. Dokumentin e gjeni si PDF tek fajlli 15 faqe: 12-13-14-15. Kërkesa e AK-së ka qenë KAMAION PER TRANSPORT TE MAKINERISË, që do të thotë se është kërkuar vetëm një pajisje e jo kombinim i dy tre pajisjeve si koka tërheqës dhe gjysmërimorkio. Si plotësim i kërkesës në formën e modifikuar ligjërisht nuk mund të pranohet.

Edhe për kundër që AK i ka cilësuar të papërgjegjshëm vetëm me arsyetimin se: **Në pozicionet 2.10, 2.11 dhe 3.04 vendosni çmime me më shumë se dy shifra dhjetore, gjë që bie në kundërshtim me nenin 17.11 Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik,** ky GOE i posedon edhe mangësitë që i cekëm më lart të cilat e bëjnë GOE në fjalë si tenderues plotësisht të papërgjegjshëm.

Mangësitë në tenderin e GOE "B CORP SH.P.K.; FS C ING SH.P.K.":
Fillimisht dua të sqaroj se të dy këto Grupe të OE posedojnë tenderin e njëjtë me staf, pajisje, organogram por edhe me gabime të njëjta tek çmimet andaj ne vetëm po i përsërisim mangësitë e njëjta.
Ky Grup i OE fillimisht ka mangësi tek paramasa pasi që disa nga çmimet i ka ofruar me më shumë presje dhjetore se sa që lejohen me ligj dhe dosje së tenderit. Në rastin konkret

tek pozicioni 2.10, 2.11 dhe 3.04 ka ofruar çmimin 0.004€, 0.004€ përkatësisht 0.001€. Kur të merret për bazë ajo që e kërkon neni 17.11 i RRPP-001/2022, del që tenderuesi i tillë është i papërgjegjshëm.
Mangësia e këtij GOE është mos dorëzimi i organogramit sipas ligjit dhe rregullores mbi organizmin e kompanive pasi që ky organogram i posedon vetëm katër pozitat udhëheqëse dhe nuk dihet fare se sa është numri i punëtorëve e as shpërndarja e tyre në sektorë.

Mangësi tjetër e rëndësishme është ajo e mos posedimit të pajisjeve sipas kërkesave të AK-së. E themi këtë sepse ky GOE nuk ka ofruar si në vazhdim:

- Tek pika 7. e listës së pajisjeve nuk ka dhënë informata mbi fuqinë e makinës ashtu siç e ka kërkuar nga AK. Kur të qasemi në internet, tipi i makinës së tillë nuk posedon fuqinë e kërkuar nga AK andaj edhe nuk mundet të pranohet. Ky GOE ka tek fajlli 12, faqe 50 ka paraqitur një faturë të plotësuar me dorë të lirë dhe ka dhënë fuqinë 138KW por që dyshohet se nuk është vërtetë pasi që makineria e njëjtë në internet nuk posedon fuqinë e tillë. Shihe linkun për pajisjen e tillë:https://www.troostwijkauctions.com/en/l/o-k-l25-5-shovel-2002-A1-22288-13
- Tek pika 8 e listës është paraqitur kompresori si gjysmërimorkio speciale-kompresor qe tërhiqet ku sipas ligjit për regjistrim te automjeteve ne RKS, ky mjet duhet te regjistrohet sepse kalon peshën mbi 750kg. Tek fatura e paraqitur në PDF si dhe tek DUD-i i doganës shihet se pajisja e tillë peshon 1990kg andaj paraqitja e sajë pa regjistrim nuk mundet të pranohet.
- OE ka ofruar kokë tërheqëse me targa 01-967-QQ dhe gjysmërimorkio për bartjen e automjeteve me targa: 01-659-XB. Dokumentin e gjeni si PDF tek fajlli 15 faqe: 12-13-14-15. Kërkesa e AK-së ka qenë KAMAION PER TRANSPORT TE MAKINERISË, që do të thotë se është kërkuar vetëm një pajisje e jo kombinim i dy tre pajisjeve si koka tërheqës dhe gjysmërimorkio. Si plotësim i kërkesës në formën e modifikuar ligjërisht nuk mund të pranohet.

Edhe për kundër që AK i ka cilësuar të papërgjegjshëm vetëm me arsyetimin se: **Në pozicionet 2.10, 2.11 dhe 3.04 vendosni çmime me më shumë se dy shifra dhjetore, gjë që bie në kundërshtim me nenin 17.11 Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik,** ky GOE i posedon edhe mangësitë që i cekëm më lart të cilat e bëjnë GOE në fjalë si tenderues plotësisht të papërgjegjshëm.

Vlen të thuhet se dy grupet e tenderuesve të cekura më lart, posedojnë pajisjet, stafin dhe shumë elemente tjera identikisht të njëjta andaj këtu dyshohet edhe për një marrëveshje **kartelë** dhe të fshehtë në mes tyre gjë të cilën na e dëshmon dhe vërteton vet AK duke mos vazhduar në përzgjedhjen tonë si fitues të tenderit edhe pse kemi pasur çmimin më të ulët dhe i kemi plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara.

Pra sipas krejt asaj që theksuam më lartë, veprimi i tillë i AK-së përpos që konsiderohet diskriminim ndaj nesh dhe favorizim i hapur i dy konkurrentëve tjerë, konsiderohet edhe shkelje e plotë e nenit 59 të LPP-së dhe disa dispozitave tjera përcjellëse nga LPP dhe RRPP-001/2022.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se OE duhet së pari të jetë i përgjegjshëm e më pas të ketë çmimin më të ulët. Në rastin tonë AK është dashur të na shpallte neve si fitues sepse i plotësojmë të dy kriteret e

nevojshme andaj me të drejtë konstatojmë se AK e ka shkelur nenin 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe **nenin 41 të RRPP-001/2022** pasi që nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të trajtimit dhe sqarimit të tenderuesve në rastet kur dyshohen se kanë ofruar çmime apo tender jo normalisht të ulët apo më mirë të themi nuk i ka marrë për bazë sqarimet e ofruara nga ne për ato që vet AK ka kërkuar. Edhe pse na kishte kërkuar sqarime dhe ne ia kishim dërguar ato me kohë, AK nuk i ka marrë për trajtim fare por ka vazhduar me arsyetime të pa bazuara gjoja për vonesa në dërgimin e tyre. Në rastin tonë AK është dashur të merrte për bazë sqarimet e ofruara me kohë nga ne dhe të vazhdonte me zgjedhjen e fituesit. Se çmimet tona të ofruara janë çmime normale të tregut, e sidomos janë çmime normale të tregut kur krahasohen me kontratat e realizuara nga vet AK në të kaluarën e afërt, mjafton të shikohet me kujdesë sqarimi i ofruar nga ne me datë 23.04.2025 të cilin AK pa të drejtë e ka cilësuar si dërgim të jashtë afatshëm. Pavarësisht kësaj ne edhe një here po deklarohemi këtu se çmimet tona janë çmime normale të tregut e veçanërisht janë normale kur krahasohen me çmimet që ka operuar vet AK për më shumë se 5 vite, andaj me të drejtë konstatojmë se AK e ka shkelur nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RRPP-së kur na ka eliminuar si tenderues me çmim jo normalisht të ulët dhe si tenderues që kinse nuk i kemi ofruar sqarimet me kohë. Për të qenë më korrekt me juve, ne edhe një here po jua sqarojmë çmimet tona ashtu siç e kërkon nenin 41 i RRPP-001/2022. Sqarimi jonë është ky:
Fillimisht po e paraqesim kërkesën e AK-së që na e ka dërguar me datë 18.04.2025 e cila duket kështu:

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, konform nenit 41.2 te Rregullores Nr.01/2022 për prokurm publik te ndryshuar me rregulloren nr.02/2024 kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Konform nenit 41.6 te Rregullores Nr.01/2022 për prokurim publik te ndryshuar me rregulloren nr.02/2024 ju lutem na sqaroni qe në ofertën tuaj financiare keni dhënë çmime të ulta për pozicionet e më poshtëm:

Pozicionet: 2.08, 3.01, 3.02, 3.03, 3.05, 3.06 dhe 3.07 te paramases dhe parallogarise tuaj te dorëzuar.

Në mënyrë që ta vlerësojmë drejtë ofertën Tuaj, konform Rregullores Nr.01/2022 për prokurm publik te ndryshuar me rregulloren nr.02/2024 ku thuhet se:

41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:
a. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për = furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

atëherë,

Na jepni një sqarim të detajuar lidhur me: ekonominë, zgjidhjen, kushtet e favorshme qe i keni ne dispozicion dhe origjinalitetin e shërbimeve dhe punëve te propozuara.

Kur dihet se:
1.Furnizim me kryp çmimi i tregut është 70 euro për ton;
2.një ekskavator 7t atëherë shpenzimet e naftës i ka mbi 8 litra për orë;
3.një ekskavator 16t atëherë shpenzimet e naftës i ka mbi 12 litra për orë;
4.një ekskavator 22t atëherë shpenzimet e naftës i ka mbi 18 litra për orë;
5.një grejder 12t atëherë shpenzimet e naftës i ka mbi 13 litra për orë;
6.një ngarkues 18t atëherë shpenzimet e naftës i ka mbi 15 litra për orë;
7.Gjithashtu gjatë përmbytjeve pozicionet 3.05, 3.06, 3.07, përfshihen Eskavator me pesha 7t, 16t dhe 22t së bashku me Kamion ku materiali duhet te transportohet deri në një lokacion të paraparë; ku ne këtë rast;

- **Një eskavator 7t** shpenzimet e naftës për **orë i ka 8 litra** ku sot me datën **16.04.2025 çmimi i tregut për naft është 1.20 euro** dhe **një Kamion shpenzimet mesatare për orë ka 20 litra** ndersa **Shofert (Manipulatoret) për Eskavator kan pagën 6.00 euro për orë**, **Shoferi i Kamionit 4.50€** me një llogaritje te thjesht: Eskavatori 7t **8l/h x 1.20€ =9.60€**, Kamioni **20 l/h x 1.20€ = 24.00€**, **Shoferi Kamionit 4.50 € ora**, **Shoferi i Eskavatorit 6.00€**, llogaritje totale për një Eskavator 7t dhe Kamion me Shofert per te dy makinerit: **9.60€ + 24.00€ + 4.50€ +6.00€ = 44.10€ Shpenzimet për Një Orë**, ndersa **oferta juaj është 0.10€** per Një Eskavator 7t dhe Kamion sipas Pozicionit: 3.05 te paramases dhe parallogarise, **ku diferenca eshte 44.00€**
- **Një eskavator 16t** shpenzimet e naftës për **orë i ka 12 litra** ku sot me datën **16.04.2025 çmimi i tregut për naft është 1.20 euro** dhe **një Kamion shpenzimet mesatare për orë ka 20 litra ndersa Shofert (Manipulatoret) për Eskavator kan pagën 6.00 euro për orë, Shoferi i Kamionit 4.50€** me një llogaritje te thjesht: **Eskavatori 16t 12l/h x 1.20€ =14.40€, Kamioni 20 l/h x 1.20€ = 24.00€, Shoferi Kamionit 4.50 € ora, Shoferi i Eskavatorit 6.00€**, llogaritje totale për **një Eskavator 16t dhe Kamion me Shofert per te dy makinerit: 14.40 € + 24.00€ + 4.50€ +6.00€ = 48.90€ Shpenzimet për Një Orë**, ndersa **oferta juaj është 0.10€** per Një Eskavator 16t dhe Kamion sipas Pozicionit: 3.06 te paramases dhe parallogarise, **ku diferenca eshte 48.80€**
- **Një eskavator 22t** shpenzimet e naftës për **orë i ka 18 litra** ku sot me datën **16.04.2025 çmimi i tregut për naft është 1.20 euro dhe një Kamion shpenzimet mesatare për orë ka 20 litra ndersa Shofert (Manipulatoret) për Eskavator kan pagën 6.00 euro për orë, Shoferi i Kamionit 4.50€** me një llogaritje te thjesht: Eskavatori 22t **18l/h x 1.20€ =21.60€**, Kamioni **20 l/h x 1.20€ = 24.00€**, Shoferi Kamionit 4.50 € ora, Shoferi i Eskavatorit 6.00€, llogaritje totale për një Eskavator 22t dhe Kamion me Shofert per te dy makinerit: **21.60 € + 24.00€ + 4.50€ +6.00€ = 56.10 € Shpenzimet për Një Orë**, **ndersa oferta juaj është 0.10€** per Një Eskavator 22t dhe Kamion sipas Pozicionit: 3.07 te paramases dhe parallogarise, **ku diferenca eshte 56.00 €.**

Para se të kalojmë tek arsyetimi, po shprehim pakënaqësinë tonë lidhur me qasjen e AK-së në pyetjen e bërë ku edhe ka kërkuar sqarime dhe në të njëjtin kohë edhe ka bërë kalkulime sipas qejfit të tyre duke tentuar të na imponoj përgjigjen tonë. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e parimeve të prokurimit dhe në të njëjtën kohë konsiderohet edhe tejkalim i kompetencave dhe presion psikologjik ndaj kompanisë tonë pasi që veprimi i tillë duket hapur të jetë tendencioz dhe shumë ndikues. Ne pretendojmë se veprimet e tilla përbëjnë tejkalim kompetencash dhe ndikim i qëllimshëm psikologjik tek OE, veprime të cilat sipas Kodit Penal të Kosovës konsiderohen vepër penale.
Kalkulimet që AK i ka paraqitur tek kërkesa për sqarim, ka pasur mundësi të i bëjë tek raporti i vlerësimit dhe të i mbaj për vete e jo të na i dërgoj neve në letrën sqaruese sepse me këtë konstatim të tyre, i ka humbur kuptimi edhe letrës sqaruese që na është dërguar. Pra shkresa e tillë nuk kuptohej se a është kërkesë për sqarim apo kërkesë për pajtim me mendimin e AK-së.
Kalkulimi i bërë nga AK përpos që është i pasaktë, është edhe i manipuluar dhe qartë shihet se kërkesa e tillë është përgatitur nga konkurrentët tonë në këtë proces e jo nga vet AK. Vlen të thuhet se ky AK nuk ka përgatitur as edhe një here të vetme sqarim dhe analizë të tillë në asnjë nga procedurat e prokurimit në të kaluarën prandaj shihet qartë se krejt kjo është hartim i dikujt tjetër që në bashkëpunim me AK-në po mundohen ta anulojnë padrejtësisht procedurën e tillë të prokurimit.
Vlen të thuhet edhe kjo që për neve është shumë shqetësuese pasi që në rastin tonë AK ka aplikuar në mënyrë selektive kërkesa të tilla sepse ky standard i sqarimit nuk është përdor

asnjëherë në të kaluarën edhe pse AK ka nënshkruar shumë kontrata me çmime të njëjta.
Lidhur me këtë, mjafton të shikoni Kontratën me Nr: GRA618-23-7538-2-1-1/C328 të cilën e ka nënshkruar ky AK pikërisht për shërbime të njëjta para kësaj procedure të prokurimit për çka nuk kanë kërkuar asnjë lloj sqarimi edhe përkundër që çmimet shihet të jenë të ngjashme me çmimet që ne i kemi ofruar në këtë tender. Nëse çmimi prej 0.10€ konsideroni se është çmim jo normalisht i ulët për një orë pune të një ekskavatori, atëherë pse nuk është çmim jo normalisht i ulët prej 1.00€ për një orë pune të ekskavatorit të njëjtë. Pra këtu po shihet se nëse do aplikohej forma e njëjtë e kalkulimit për kontratën e kaluar, edhe çmimet e tilla do dilnin të jenë jo normalisht të ulëta dhe nga këtu shihet qartë aplikimi i standardeve të dyfishta dhe aplikimi selektiv i ligjit nga ana e AK-së. Për të ju bindur se edhe tek kontrata me Nr: GRA618-23-7538-2-1-1/C328 AK ka pasur çmime të ngjashme, po ua paraqesim në formë vizuale pjesën e kontratës ku shihen çmimet e tilla:

Čišćenje, pranje puteva i trotoara, zimsko i letnje održavanje puteva i razne intervencije u opštini Gračanica

Kategorija 1				
I	PRIPREMNI RADOVI	jedinica	kolicina	Cena sa PDV
1.1	Čišćenje i uklanjanje svih prirodnih i veštačkih prepreka zatečenih na projektovanoj trasi, uključujući drveće prečnika do 40 cm, betonske i metalne ograde i druge sa odvozom do deponije ne dalje od 5 km	m'	1	0.10
1.2	Raščišćavanje terena i uklanjanje žbunja	m^2	1	0.10
